



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE ARKIV-PROTOKOLLIT

Nr. 444/3 Prot.,

Tiranë, më 02/02 2024

SHPALLJE
TË LISTËS SË KANDIDATËVE TË KUALIFIKUAR
DPAKU

Në mbështetje të ligjit nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në RSH”, i ndryshuar, neni 19, pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në RSH”, të ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, i ndryshuar, të Rregullores së Brendshme për organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, të miratuar me Urdhrin nr.297 datë 23.6.2022. të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ligjit nr. Nr.9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, në VKM-në nr. 708 datë 9.9.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, Ligjit nr. 10433 datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Urdhrit të Kryeministrit nr. 128, datë 26.10.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, Manuali i Rekrutimit (i ndryshuar),

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, në përfundim të procesit të verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacioneve të dorëzuara nga kandidatët për 1 (një) pozicion të lirë pune të shpallur në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së:

- 1 (një) pozicion të lirë pune “*Specialist*” në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së;

N J O F T O N:

1. Lista e kandidatëve të kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit është si vijon:

- Për pozicionin e lirë të punës “*Specialist*” në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së:
 - **Z. Endri Leka**

2. Intervista do të zhvillohet **më datë 5.2.2024, ora 09:30**, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU, adresa Rruga “Bardhyl”, Ndërtesa Nr. 93, Njësia Administrative Nr. 3, Tiranë.
3. Kandidati do të intervistohet në lidhje me:
 - Njohuri mbi Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
 - Njohuri mbi Ligjin nr.9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar;
 - Njohuri mbi VKM-në nr. 708, datë 9.9.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”.
4. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht:
 - 50 pikë për jetëshkrimin/eksperiencën/pastërtinë e figurës.
 - 50 pikë për intervistën me gojë.
5. Shpallja e fituesve bëhet në faqen zyrtare brenda 3 ditëve pune nga përfundimi i intervistës.
6. Çdo kandidat ka të drejtën për ankim jo më vonë se 24 orë nga shpallja e listës së fituesve.

DREJTORI PËRGJITHSHËM

EDMOND RRUSHI

